

V E N D I M
Nr. 98, datë 4.2.1998

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.153, DATË
26.3.1997 DHE NR. 200, DATË 2.5.1997, SI DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.360 DATË 10.7.1995**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.153, datë 26.3.1997 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 10.7.1995 “Për regjimin e eksport-importit nga dhe në Republikën e Shqipërisë”” shfuqizohet.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 2.5.1997 “Për disa masa për forcimin e ruajtjes së mallrave, pajisjeve e objekteve ushtarake dhe shtetërore” shfuqizohet.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 10.7.1995, pika 2 ndryshohet si vijon:
“Eksporti i mallrave nga Republika e Shqipërisë është i lirë me përjashtim të mallrave të mëposhtme, eksporti i të cilave është i ndaluar:

72.04. Skrape të gizës dhe çelikut (me përjashtim të skrapeve të çeliqueve të pandryshkshëm dhe mbetjeve të gizës nga kovat e furrëllartës).

74.01 deri 74.19. Bakri dhe artikujt prej bakri (me përjashtim të skorjeve të bakrit, bakrit elektrolitik dhe prodhimeve artistike të imta prej bakri jo të derdhur)”.

4. Aktiviteti i grumbullimit dhe i përpunimit të mbetjeve dhe skrapeve metalike bëhet me leje nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit që, brenda datës 10 shkurt 1998, të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano